

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Çfarë është një “anëtar i asociuar” i BE-së dhe pse Kanadaja është e para? - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/cfare-eshte-nje-anetar-i-asociuar-i-be-se-dhe-pse-kanadaja-eshte-e-p-ara/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 08:25:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 08:24:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8786de11a1e0df16387943ced0aee58cb117cccd3af54c3a349e2446e3f2d37f
TEKSTI	01cafd3214538191162e268ef4492b7aaaf5c88967882ffad4e48e913bc896aa
PAMJA	99be69b2942fca2ebaff9a6e8e823eb2f01c5a8c271f9929d24c3c046c189c25

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fa4117718d2e143ee54b42f56bebc6e22f61aee0b10b9390649e0f074a2ee858
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	00c036a8b9d029228ae2ceb40f7ad3139dd1ddd4285277109f3fa37fa73abd7e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fa4117718d2e143ee54b42f56bebc6e22f61aee0b10b9390649e0f074a2ee858>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

BE Katari Lufta në Iran France Francë

BOTA

Çfarë është një “anëtar i asociuar” i BE-së dhe pse Kanadaja është e para?

29 Shtator 2026 | 10:24

Presidentja e Komisionit European, Ursula von der Leyen, e ftoi zyrtarisht Kanadanë të bëhet “anëtarja e asociuar” e parë e Bashkimit European. Çfarë është një “anëtar i asociuar” dhe çfarë do të nënkuptonte kjo për Kanadanë dhe BE-në?

Duke iu drejtuar kryeministrit kanadez Mark Carney në Strasburg, von der Leyen tha se dëshironte ta çonte marrëdhënien “në nivelin më të lartë të mundshëm” në këtë “botë haptazi armiqësore”.

Kanadaja është afruar gjithnjë e më shumë me BE-në, ndërsa marrëdhëniet me Uashingtonin janë ftohur nën administratën Trump. Bisedimet tregtare dështuan në gusht të vitit 2026 dhe Trump iu përgjigj me tarifa agresive nga 25% deri në 50% ndaj mallrave kanadeze. Ai gjithashtu kërcënoi sovranitetin e Kanadasë, me deklarata për përthithjen e vendit dhe shndërrimin e tij në “shtetin e 51-të të SHBA-së”.

Për arsye gjeografike, Kanadaja nuk mund të bëhet anëtare e plotë e BE-së, ndaj Komisioni European po propozon një status të ri, atë të “anëtarit të asociuar”. Meqë ky status nuk ekziston në traktatet e BE-së, forma e tij ligjore dhe institucionale mbetet e paqartë.

“Çfarë do të jetë saktësisht? Kjo do të përcaktohet gradualisht nga pikëpamja ligjore”, tha për Euronews eurodeputeti Javier Moreno Sanchez, kryetar i Delegacionit të Parlamentit European për marrëdhëniet me Kanadanë.

Ndryshe nga një partner i thjeshtë tregtar, Kanadaja do të integrohej drejtpërdrejt në bazën industriale të mbrojtjes së Europës, do të merrte pjesë në projekte të përbashkëta në Arktik, do të bashkëpunonte në fushat e inteligjencës artificiale, qëndrueshmërisë kibernetike dhe informatikës kuantike, si dhe potencialisht do të përfronte politikat në sektorin e shërbimeve financiare.

Megjithatë, ajo nuk do të fitonte të drejtën e votës në Parlamentin European dhe as të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjen për ligjet thelbësore të BE-së.

Një partneritet që ekzistonte më parë

Marrëdhëniet mes Kanadasë dhe BE-së ishin tashmë miqësore, të qëndrueshme dhe të orientuara drejt interesave konkrete.

Në vitin 2016, ato nënshkruan dy traktate të rëndësishme: Marrëveshjen Gjithëpërfshirëse Ekonomike dhe Tregtare dhe Marrëveshjen e Partneritetit Strategjik.

LAJMI I FUNDIT

10:23 Ministri i Jashtëm i Iranit: Katari i ka paraqitur SHBA-së ide të reja për rihapjen e Hormuzit

10:16 I dënuar për vrasje me paramendim, kapet në Itali 28-vjeçari shqiptar

10:15 Komisioni Evropian propozon kufizimin e të drejtave për anëtarët e ardhshëm të BE-së

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

10:13 “Vite zhvillimi brenda pak muajsh”, shkencëtarët paralajmërojnë për një shpërthim të inteligjencës artificiale

10:13 Identifikohen përmes ADN-së edhe dy viktima të luftës në Kosovë

10:11 Operacion kundër krimit të organizuar, policia britanike arreston 17 persona

TESTIM

E para hoqi 98% të tarifave, duke rritur me më shumë se 80% tregtinë dypalëshe të mallrave dhe shërbimeve, në 130 miliardë euro.

E dyta u përqendrua në dialogun për politikën e jashtme dhe i mundësoi BE-së dhe Kanadasë të zhvillonin bisedime të rregullta për ndryshimet klimatike, kërkimin shkencor dhe të drejtat e njeriut.

Fitorja e Carney-t në vitin 2025 e ngriti marrëdhënien në një nivel tjetër, me nisjen e "Partneritetit të Ri Strategjik BE-Kanada të së Ardhmes".

BE-ja nisi ta trajtojë Kanadanë më pak si një partner tregtar të largët, ndërsa të dyja palët u përafëruan për zinxhirët e furnizimit me minerale kritike, bateritë për automjetet elektrike, energjinë e pastër dhe projektet në Arktik.

Kanadaja është gjithashtu pjesëmarrëse aktive në Horizon Europe, programi kryesor i BE-së për kërkimin shkencor.

Në shkurt të vitit 2026, Kanadaja u bë vendi i parë jo-europian që iu bashkua instrumentit SAFE prej 150 miliardë eurosh, duke u mundësuar kompanive kanadeze të mbrojtjes të konkurrojnë për kontrata të përbashkëta europiane të prokurimit ushtarak.

Kanadaja u bë gjithashtu kontribuuese nga një vend i tretë në projektet e PESCO-s (Bashkëpunimi i Përhershëm i Strukturuar) për lëvizshmërinë dhe logjistikën ushtarake.

SHBA-ja mbetet eksportuesi numër një për Kanadanë, duke përbërë 72.5% të eksporteve të saj të mallrave në vitin 2025, krahasuar me 12.4% për Europën dhe Azinë Qendrore.

CETA-ja mbetet e bllokuar, pasi 10 nga 27 shtetet anëtare të BE-së ende refuzojnë ta ratifikojnë plotësisht.

Vende si Italia, Franca dhe Polonia argumentojnë se Kanadaja ka standarde më të ulëta mjedisore dhe të prodhimit në fusha si bujqësia, përfshirë përdorimin e pesticideve kimike dhe organizmave të modifikuar gjenetikisht, të cilat janë të kufizuara ose të ndaluara në BE.

Propozimi

Asnjëra palë nuk po shqyrton anëtarësimin e Kanadasë në BE.

Synimi është thellimi i partneritetit ekonomik dhe strategjik përtej nivelit aktual të bashkëpunimit.

"Ne e dimë se bëhet fjalë për një partneritet më të thellë, por më pak se anëtarësimi i plotë. Se ku saktësisht do të pozicionohet në këtë spektër, do të duhet të negociohet. Pritshmëria është që të jetë më shumë se një marrëveshje e tregtisë së lirë", tha Fabian Zuleeg, shef ekzekutiv dhe kryeekonomist i European Policy Centre.

Ideja është të ndërtohet mbi CETA-n dhe të zhvillohet ajo në një "Aleancë për të Ardhmen, për të krijuar një hapësirë të përbashkët prosperiteti dhe sigurie ekonomike", siç tha presidentja von der Leyen.

Ndërsa detajet mbeten të panjohura, partneriteti pritet të përfshijë politika që shtrihen nga prodhimi, energjia dhe mineralet te AI, informatika kuantike dhe siguria kibernetike.

Në të përfshihen gjithashtu një projekt i përbashkët në Arktik, një aleancë teknologjike dhe një bazë industriale e integruar e mbrojtjes.

Kryeministri Mark Carney sugjeroi lëvizjen "drejt një tregtie dixhitale pa pengesa për mallrat jo-bujqësore dhe një gamë të gjerë shërbimesh", duke shqyrtuar gjithashtu një treg më të integruar të shërbimeve financiare.

Sipas Zuleeg, partneriteti do të përqendrohet kryesisht te kohezioni gjeopolitik dhe për këtë arsye është një "situatë ku fitojnë të dyja palët".

"Bëhet fjalë për vende me të njëjtin vizion që bashkohen, gjejnë zgjidhje të përbashkëta për sfidat e mëdha me të cilat përballemi të gjithë kolektivisht, përfshirë një situatë mjaft të vështirë me SHBA-në", tha ai për Euronews.

Shkëmbimi i burimeve

Kjo aleancë është pjesërisht një mekanizëm mbijetese për Kanadanë.

Shkaktarët ishin dështimi i negociatave dypalëshe tregtare me SHBA-në, nga e cila varet rreth 70% e ekonomisë kanadeze të eksporteve, dhe kërcënimet e Trump për përthithjen e vendit.

Moreno Sánchez tha se zyrtarët kanadezë e kishin përshkruar dështimin e negociatave në terma jashtëzakonisht personalë.

"Ata shpjeguan se gjeografia nuk mund të ndryshohet. Ata u ndjenë të tradhtuar sepse ishte fqinji i tyre, vëllai në pragun e derës, dhe më pas një ditë u thotë: 'Nuk të dua më'. Kjo i preku shumë rëndë", tha ai.

Por partneriteti nxitet po aq edhe nga nevoja e BE-së për siguri ekonomike dhe lëndë të para.

Blloku ka humbur aksesin te energjia e lirë ruse dhe po përballlet me tensione në rritje me Kinën, ndaj ka nevojë për një burim të qëndrueshëm materialesh kritike.

"Kanadaja ka gjithcka", tha Moreno Sánchez. "Është vendi i dytë më i madh në botë

Energji, gaz, lëndë të para kritike. Natyrisht, është në interesin tonë të tregtojmë me të.”

Kanadaja ka rezerva të mëdha të litiumit, nikelit, kobaltit dhe tokave të rralla, të gjitha thelbësore për tranzicionin energjetik të BE-së dhe zinxhirët e furnizimit për bateritë.

“Deri tani, me gazin rus dhe me Kinën, gjërat funksiononin ndryshe”, tha Moreno Sánchez.

“Por tani që marrëdhëniet ndërkombëtare janë bërë më të tensionuara dhe nuk e dimë se si do të përfundojë ky rend botëror, duket sikur mund të kthehet në ligjin e më të fortit. Kjo të bën të zgjohesh dhe të thuash: ‘Duhet ta shohim këtë ndryshe’.”

Ai iu referua Gjermanisë si një paralajmërim.

“Shikoni çfarë ndodhi në Gjermani. Ata u mbështetën te gazi rus. Kur ai u ndërpre, mbyllën centralet e tyre bërthamore dhe nuk kishin alternativë. Tani po djegin qymyr për të prodhuar energji elektrike, që është pikërisht ajo që nuk duhet të bëjmë.”

Si mund të përfitojnë europianët

Në varësi të mënyrës se si partnerët do ta përcaktojnë “anëtarësimin e asociuar”, ai do të ketë pasoja konkrete për europianët.

Ndikimi më i rëndësishëm do të ishte në sektorin e energjisë, sipas Dr. Giuseppe Spatafora, analist politik në Institutin e Bashkimit European për Studime të Sigurisë.

“Unë supozoj se eksportet kanadeze të energjisë drejt BE-së do të lehtësonin presionin mbi tregun energjetik të BE-së, duke rritur furnizimin dhe duke ulur varësinë nga furnizues të tjerë.”

Megjithatë, kjo do të kërkojë kohë, pasi Kanadasë i mungon infrastruktura për të eksportuar sasi të mëdha të energjisë jashtë Amerikës së Veriut dhe ekziston një gatishmëri e kufizuar për të ndërtuar tubacione ose terminale të reja eksporti, shtoi ai.

Heqja e barrierave për investimet do t’u hapte derën kompanive të reja, shpjegoi Spatafora, ndërsa bashkëpunimi më i fortë në fushën e mbrojtjes mund të krijonte vende të reja pune dhe të ndihmonte në mbrojtjen e shoqërive europiane dhe kanadeze.

Kanadaja është e pasur me litium, grafit, nikel, kobalt dhe bakër, përbërës kyç për shumë sektorë, nga bateritë dhe automjetet elektrike te elektronika dhe mjekësia.

Të pasurit e Kanadasë si një “furnizues i sigurt” do t’i ndihmonte kompanitë e BE-së të vazhdonin aktivitetin, ndërsa do të reduktonte ndikimin e vendeve si SHBA-ja dhe Kina.

“Kanadaja do të ishte sigurisht një furnizues shumë më i sigurt se Kina. Nëse kjo do të përkthehet në ringjalljen e industrisë së automobilave, nuk jam i sigurt, duke pasur parasysh kontrollin që Kina ka mbi të gjithë zinxhirin e furnizimit. Por sigurisht që mund të ndihmojë përpjekjet e BE-së për të zhvilluar industri strategjike, si mbrojtja dhe prodhimi i avancuar”, tha Spatafora.

Kryeministri Mark Carney propozoi forcimin e “lidhjeve mes njerëzve” duke përfshirë Kanadanë në Erasmus+ dhe Horizon Europe të BE-së.

Kjo mund të nënkuptojë rregulla më të thjeshta për vizat e studentëve europianë që duan të studiojnë përtej Atlantikut, si dhe projekte të përbashkëta kërkimore dhe inovacioni.

Çfarë ndodh më tej?

BE-ja do të duhet të krijojë nga e para kuadrin ligjor për “anëtarësimin e asociuar”, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e të dyja palëve.

Sfidat kryesore mund të përfshijnë përafrimin e rregulloreve të partnerëve dhe sigurimin e miratimit unanim nga të 27 shtetet anëtare.

Zuleeg shpreson që samiti i ardhshëm BE-Kanada në Montreal, më 29-30 tetor, do ta qartësojë termin dhe do ta shndërrojë ofertën e BE-së në një propozim konkret.

“Negociatat janë duke vijuar. Nga këndvështrimi im, do të ishte një mundësi e humbur nëse, deri në takimin e tetorit, nuk do të kishim përparim konkret në tryezë”, tha ai për Euronews.

Përparimi i suksesshëm mund të ngrejë pyetjen nëse Kanadaja do të jetë një rast i veçantë apo nëse BE-ja mund ta vendosë këtë si një formë të re partneriteti edhe për vende të tjera.

Partneriteti me Kanadanë mund të jetë “fara” e një “aleance shumë më të gjerë mes vendeve me të njëjtin vizion, që punojnë së bashku”, e cila mund të ketë një efekt shumëfishues, shpjegoi Zuleeg.

“Nëse tregojmë një front të bashkuar mes BE-së, Kanadasë, Mbretërisë së Bashkuar, Norvegjisë, Islandës, por edhe vendeve si Australia, Zelanda e Re, Japonia dhe Koreja e Jugut, atëherë do të kemi vërtet një masë kritike, e cila do të jetë e vështirë të injorohet edhe nga SHBA-ja dhe Kina”, shtoi ai.

Bashkëpunimi më i fortë me partnerët e afërt joeuropianë nuk do të dëmtojë rrugën e vendeve candidate drejt anëtarësimit të plotë dhe as nuk do ta zëvendësonte atë me statusin e anëtarit të asociuar.

Moreno Sanchez shpjegoi se “zgjerimi ka rrugën e vet, ndërsa marrëdhëniet me partnerët e besueshëm kanë rrugën e tyre” dhe se këto procese “po zhvillohen paralelisht”.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

BOTA

Ministri i Jashtëm i Iranit: Katari i ka paraqitur SHBA-së ide të reja për rihapjen e Hormuzit

Ndërmjetësit e Katarit do t'i paraqesin SHBA-së ide të reja të diskutuara me Teheranin se si të përmbushen kushtet e Iranit për rihapjen e Ngushticës...

10:23 | 29/09/2026

BOTA | EVROPA

Komisioni Evropian propozon kufizimin e të drejtave për anëtarët e ardhshëm të BE-së

Komisioni Evropian do të propozojë kufizimin e disa të drejtave për anëtarët e ardhshëm të Bashkimit Evropian (BE), si dhe kalimin në vendimmarrje me shumicë...

10:15 | 29/09/2026

BOTA

“Vite zhvillimi brenda pak muajsh”, shkencëtarët paralajmërojnë për një shpërthim të inteligjencës artificiale

Dy prej figurave më të rëndësishme në zhvillimin e inteligjencës artificiale, Geoffrey Hinton dhe Yoshua Bengio, po u kërkojnë qeverive të përgatiten për mundësinë e...

10:13 | 29/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.